

**22.08.2024**

**Ora 11:15**

***RENDI I DITËS***


**“Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.11 datë 9 gusht 2024, depozituar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt “Kundështimi i vendimit nr.85, datë 5.08.2024, “Për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultateve për zgjedhjet e Kryetarit të Bashkisë Himarë”, në zgjedhjet e pjesshme të datës 4.08.2024 të KZAZ-së nr.88”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,  
z. I. Rusmali (online), z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Znj. D. Alimemeti, z. M. Bardhi
- **Parti Politike:** Z. F. Nuri (BF)
- **Të tjera:** KRIIK

**Z. K. Bele:** Përshëndetje! Riçelim seancën, për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore nr.11, vazhdojmë atje ku e lamë ditën e djeshme. Prezent është KAS-i, me katër anëtarët e vet, gjithashtu anëtari i pestë është i lidhur nëpërmjet komunikimit elektronik. Ne relatojmë se në seancën e djeshme u bë një diskutim në lidhje me marrjen e provave. Nga pala ankuese u kërkua kohë për të bërë disa plotësime apo për të reflektuar ato çka i morëm me provat shkresore, me qëndrimin që ata do të mbajnë në seancën e sotme. Jemi në rrethanat e dëgjimit të palëve, të ankuesit, në harmoni me gjetjet dhe faktet, e administruara gjatë ditës së djeshme. Rikujtoj avokatin që kërkesën ankimore e kemi para nesh me shkrim, një pjesë të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024*

qëndrimeve janë mbajtur ditën e djeshme, kështu që do ju lutesha të fokusoheshit te çështje faktike që të mos bëjmë përsëritje të panevojshme. Faleminderit!

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po, faleminderit! Ne patëm mundësi të njiheshim shkurtimisht për aq pak kohë sa na u vu në dispozicion për këto tre-katër shkresa, që arritëm të marrim më në fund nga administrata e KQZ-së. Patjetër, që desha të bëj një hyrje të shkurtër, të gjithë e dimë që zgjedhjet u dekretuan në 4 gusht, me dekretin e Presidentit, pa dashur ta analizojmë këtë pjesë sepse është diçka që është trajtuar dhe politikisht. Unë do qëndroj vetëm tek pjesa ligjore e ankimit tonë. Me dekretin e Presidentin u caktua data e zgjedhjeve në Himarë, me 4 gusht, KQZ regjistroi subjektin “Partia Demokratike” si subjekt zgjedhor në 23 korrik, në 25 korrik KQZ-ja regjistroi koalicionin “Bashkë Fitojmë”, kryesuar nga Partia Demokratike për zgjedhjet e pjesshme të Himarës. Sikundër e kemi cituar edhe e kemi përmendur edhe dje, koalicioni “Bashkë Fitojmë” e konteston Tabelën Përbledhëse të Rezultateve, për arsyet dhe shkaqet që ne do t'i paraqesim në vijim. Por më lejoni, që të bëj dhe një parantezë në lidhje me kontekstin e trajtimit dhe ankimit tonë në KAS dhe në KQZ. Përpara se t'i parashtroj pretendimet, koalicioni “Bashkë Fitojmë” pasi depozitoi në 9 gusht, të premten në mbrëmje ankiminim në KQZ, të nesërmen ditë e shtunë, u njoftuam me urgjencë nga administrata e KQZ-së për mbajtjen e seancës paraprake, seancën e parë, atë të legjitimimit formal, të kërkuesit, ku u paraqitëm dhe e shrytëzuam menjëherë këtë mundësi që na u dha. Për të kërkuar provat që KQZ-ja dispononte, nga ne dhe nga anëtarët e KAS-it, administratës së KQZ-së iu bë e qartë që kërkuesit duhet t'i viheshin në dispozicion këto prova. Për ta formalizuar kërkësen tonë, depozituam kërkësë edhe me shkrim, të protokolluar në KQZ në datë 13 gusht, seanca e themelit, seanca e parë e themelit u caktua me datë 21, mbas 11

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimoreve dhe Sanktioneve  
Dt. 22.08.2024*

ditësh. Ndërkokë KQZ-ja pati të paktën 8 ditë të plota kohë, që të na i vinte në dispozicion ato prova që kishte. Çfarë ndodhi? KQZ-ja na i mbajti të fshehura ato dokumenta. Pse e themi këtë gjë? Sepse në fillim të seancës së djeshme përfaqësuesit e KQZ-së në sallën e KQZ-së e pohuan se i kishin, një pjesë të dokumentave aty, po pse nuk na i vunë në dispozicion? Qoftë dhe një orë përpëra, nuk po flas një, dy ditë përpëra që ne të kishim mundësi, në mënyrë efektive të njiheshim me këto dokumenta, për qëndrimin tonë. Prandaj e themi që këto dokumenta na u mbajtën të fshehura dhe nuk na u vunë në dispozicion. Pas këmbënguljes tonë dje dhe debateve që patëm këtu në seancë, u pezullua seanca 45 minuta me idenë që të na viheshin në dispozicion ato materiale që ishin apo që KQZ-ja mund të arrinte të mblidhët në atë moment dhe ne të njiheshim me to.

**Z. K. Bele:** Më fal, po ju po tregoni se çfarë ka ndodhur në seancën e djeshme? I bie që po relاتoni atë. Ne ishim prezent, gjërat janë publike, janë audio. Unë nuk jam nga ata që të ndërpres fjalës, se kemi bërë disa herë seanca bashkë. Po të lutem kthehem te çështja.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Shkurtimisht.

**Z. K. Bele:** Të tregojmë sa minuta ndenjëm dje në pushim, nuk mendoj se i vlen kësaj seance.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** ...isha duke përfunduar. I vlen pjesës që ne duam të arrijmë, tek pjesa e asaj që nuk na është dhënë mundësia efektive për të bërë një mbrojtje efektive dhe një proces të rregullt. Këtu e kishim, domethënë qëllimin. Megjithatë pa u zgjatur, materialet nuk na u vunë në dispozicion as gjatë

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe SankSIONeve  
Dt. 22.08.2024*

pushimit, por na u vunë pak sekonda pasi rifilloi seanca, madje dhe ato ishin të cunguara. Na u vunë në dispozicion 4 shkresa gjithsej, raporti i audituesit teknicien fotokopje, që e kemi këtu. U vu në dispozicion kjo shkresa këtu, e Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, një shkresë përcjellëse. Një listë me anëtarët e Partisë Socialiste të Komisioneve të Qendrave të Votimit, e paplotë në fillim dhe më pas u korigjua nga administrata, na erdhi dhe lista e plotë. Më vonë na u vu në dispozicion dokumenti që ishte... na u vu në dispozicion dhe një listë exel-i ku u debatua dhe dje. Janë një sërë problematikash që dua t'i ngre, është kjo lista këtu. Gjatë seancës na u vu në dispozicion, më pas, një dokument tjetër më i rëndësishëm akoma, që ishin komunikimet me email me kompaninë Smartmatic, ku dilnin dhe emra personash konkretë. Me dokumenta konkrete që figuronin nga Gjendja Civile apo nga PEI nuk ka rëndësi, figuronin këta persona me dokumenta të skaduara, ndërkohë që dokumentat i kishin të vlefshëm, nga verifikimet që ishin bërë në terren. Kjo ishte për të thënë dhe atë që sapo e thashë i nderuar që nuk patëm mundësi që të na viheshin provat. Provat na u fshehën, na u vunë në dispozicion me vonesë, në mënyrë të përpjekshme, nuk kemi pasur mundësi efektive, as kohën e mjaftueshme për të bërë qoftë dhe këto parashtrime sot. Se seanca dje u ndërpri rreth orës 16 dhe u la sot në 11, pra as 24 kohë, për t'i analizuar të gjithë këto elementë dhe për t'i sjellë sot dhe të gjitha këto bënë që ne nuk kemi...Nuk na është garantuar e drejta për një mbrojtje efektive dhe unë gjykoj se këtu cënohet pak procesi i rregullt ligjor, por kjo është një çështje që ndoshta do ta ndjekim dhe në etapat e tjera, për të hyrë te thelbi tashmë. Nga këto elementë që na janë vënë në dispozicion ne konstatojmë që këto... Kjo tabelë u kontestua dje dhe u vu në dyshim edhe nga përfaqësuesi i Partisë Socialiste sepse tha për shifrën e 53 qytetarëve të Himarës që dalin sikur janë me pasaporta të vlefshme nga 23000, ai tha që mund të jetë lapsus, mund të jetë një gabim material, nga nxitimi, por nëse

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024*

kjo kutia këtu që ka këtë shifrën 53 mund të jetë një gabim po pse mos të jenë gabim dhe të tjerat pastaj? Shtroj unë pyetjen, pse mos të jenë gabim dhe këto shifrat e tjera këtu? Kush na i garanton që ky dokument është i saktë atëherë, kush na e garanton që këto janë të dhëna të sakta, të plota, të qarta dhe të rregullta. Po çfarë thotë kjo tabelë? Le t'i referohemi kësaj, thotë që edhe pse ka disa pjesë anglisht, por thotë që janë të paktën 388 zgjedhës të verifikuar pa shenja dhe thotë rrreth 1488.

**Z. K. Bele:** Do filloni me parashtrimet?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po këto janë...

**Z. K. Bele:** Për çfarë keni ardhur para nesh sot?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** ...e kemi depozituar me shkrim i nderuar.

**Z. K. Bele:** Dakord. Për parashtrimet, një hyrje shumë të shkurtër, cili është kazusi që ju pretendoni dhe pastaj mbështeteni te ato prova, deri tani po tregojmë historinë e administratës. Megjithatë...

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Jo, ishim duke debatuar për provat faktikisht, meqenëse e nisëm debatin dhe dje. Unë besoj se edhe KAS-i dhe të gjithë e kanë të qartë se çfarë ne kërkojmë, ne kërkojmë kontestimin e zgjedhjeve, pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendrat e votimit të Bashkisë Himarë dhe në të gjitha qendrat e votimit. Bazuar në nenin 160, për shkak se kanë ndodhur shkelje të rënda të ligjit, kanë cënuar procesin zgjedhor dhe tërsia e shkeljeve të ligjit sipas


*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024*

vlerësimit tonë, të ndodhura në këto qendra votimi mund të kenë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve dhe kërkojmë rregullimin e pasojave duke shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe ripërsëritjen e tyre. Kjo është ajo që kërkojmë në thelb, i nderuar. Por besoj se KAS-i e ka të qartë tashmë këtë gjë. Për të hyrë të elementet e provave, po vazhdoj domethënë, janë të paktën 1438 shtetas sipas këtij materiali, që dalin me verifikim të gabuar. Këtyre si numër ne i shtojmë edhe faktin që rezultojnë të paktën 311 zgjedhës të zhvendosur, nga bashkitë e tjera sipas raportit të audituesit teknicien deri në qershor të 2024, që është dhe një tjetër problematikë. Pastaj nga dekretimi i zgjedhjeve, sipas raporteve të vëzhguesve ka mbi 96 zgjedhës të tjerë të zhvendosur në Bashkinë e Himarës nga bashkitë e tjera. Kjo shifër nuk është shifër e neglizhueshme, duke nisur nga fakti që zgjedhjet në Himarë, në Bashkinë e Himarës, në maj të 2023, rezultuan me një diferençë prej 18 votash midis kandidatëve. Këtyre shifrave ne duam t'i shtojmë gjithashtu 560 zgjedhës në Himarë që nuk janë lejuar të votojnë për shkak se kartat e identitetit të tyre rezultuan të skaduara në procesin kur ishin në mesin e procesit zgjedhor, pa përmendur faktin që është i ditur botërisht tashmë të mbi 6000 zgjedhës që janë evidentuar nga vetë pajisja PEI apo nga kompania që menaxhon pajisjen PEI, që janë me karta identiteti të skaduara, në pamundësi për të votuar. Nga totali mbi 6000 zgjedhës në Bashkinë e Himarës, ne pretendojmë që janë të paktën 560 që iu është ndërprerë procesi i votimit në mes, duke shkelur barazinë e votës, duke cënuar procesin. Për këto dhe për 260 zgjedhës të tjerë që pretendojmë ata sipas informacioneve që kemi marrë, nga terreni, këta zgjedhës kanë pasur karta të rinovuara ditët e fundit. Ne pretendojmë për këta zgjedhës dhe kërkojmë marjen e provës duke hapur kutitë e materialeve zgjedhore në mënyrë që të na vihen në dispozicion ato prova që ne kërkua dje, që janë procesverbalet e regjistrave të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimoreve dhe Sanktioneve  
Dt. 22.08.2024*

posaçëm, ku mund të jenë evidentuar 560 zgjedhës ose më shumë që nuk janë lejuar të votojnë pasi kartat ID e tyre rezultonte me datë të skaduar dhe procesverbalet ku mund të jenë shënuar manualisht, të paktën 260 votues, të cilët PEI nuk i njihte, aparati i identifikimit elektronik nuk i njihte, por rezultonin me karta të rinovuara rishtas dhe për këtë kërkojmë dhe e ripërsërisim një vendimmarrje nga ana e KQZ-së. Këto janë në vija të përgjithshme shkeljet me shifra që ne arrijmë të gjejmë për kaq pak elementë që na u vunë në dispozicion deri tani dhe mendojmë që të gjitha këto po t'i akumulojmë bashkë, shifrën e mbi 6000 zgjedhësve që janë penguar të votojnë, ndryshe nga herët e tjera, ndryshe nga ajo çka u tha dhe dje këtu në seancë, ku në zgjedhjet e pjesshme të Kukësit, mund të jenë lejuar të votojnë zgjedhës, kështu u dëgjua në seancë dje të paktën, edhe me karta të skaduara dhe pa VKM, të marrë nga qeveria për t'i shtuar vlefshmërinë kartave për ditën e zgjedhjeve. Ndryshe nga 3 palë zgjedhje të tjera në Bashkinë e Himarës ku zgjedhësit, me karta të skaduara e kanë pasur mundësinë të votonte, pra i njëjti zgjedhës para një viti arriti të votojë me kartën e skaduar në Himarë, këtë herë iu mohua kjo e drejtë. Pra, ky është elementi i parë, elementi i dytë janë të gjithë këto shifra që ne përmendëm deri tani dhe që kanë bazueshmëri në këto shifra dhe në këto materiale që kemi arritur të marrim nga administrata e KQZ-së. Ndërkohë pjesë tjetër të elementëve ne do donim që të nq vihej në dispozicion nga administrata e KQZ-së, pasi KAS-i shpresojmë të marrë një vendim në këtë drejtim.

**Z. K. Bele:** Për të ndihmuar procesin i kam kërkuar administratës të na sjellë “Librat e portokollit” të KAZA-së edhe për të qartësuar ndonjë gjë dhe atyre pretendimeve që u ngriten. Është “Libri i protokollit”, “Libri i korrespondencës”, “Libri i vendimeve” të KAZA-së 88 dhe tabelat për çdo QV, mos ka ndonjë shënim

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve*  
*Dt. 22.08.2024*

apo ndonjë gjë. Nga një këqyrje, që i shoh, nuk ka ndonjë shënim në tabelat e QV-ve ku bëhet numërimi. Kam vetëm... Ju mbaruat me parashtrimin tuaj?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Në lidhje me dokumentat që sapo na u vunë në dispozicion kam një pyetje për administratën e KQZ-së. Dje na referuat se një pjesë e këtyre materialeve, mos gjithë këto materiale gjendeshin në kutitë e materialeve...

**Z. K. Bele:** Më fal, se ndoshta nuk e shpjegova drejt, ndoshta as unë as ju nuk jemi ekspertë të asaj po për shkak të një lloj ekspericençë këtu kemi mësuar për ca gjëra. Këto janë dokumenta që i kanë palët në proces, pra subjekti politik, dokumentat e KZAZ-së bëhen në kopje dhe secila palë ka kopje e veta, pra ky është një dokument që e ka pala ankuese dhe tipikisht janë përdorur kur ngrihen pretendime dhe nga një vështrim i datës 4.08.24, procesverbali i mbajtur nga 7 anëtarët të KZAZ-së, ju rikujtoj se 4 nga anëtarët të cilët kanë qenë përfaqësues të koalicionit të subjektit ankues. Po e lexoj është e shkurtër: "Sot me datën 4.08.24 u mblodh KZAZ-ja në orën 6.30, u koordinua, u ndanë QV-të kù kishte problematika me hapjen. Filloi procesi i votimit, në të gjitha qendrat e votimit deri në orën 8. Problematika të hasura gjatë ditës, numri i madh i kartave ID të skaduara." E konstaton KZAZ-ja. "Gjatë ditës votimi ka shkuar shumë mirë" –thotë KZAZ-ja. "Në orën 7 mbylljet procesi, në 7.30 dorëzimi. Çdo gjë përfundoi me dorëzimin e të gjitha qendrave të votimit". Pra, vetë KZAZ-ja, e vëmja problematikë e konstatuar votimi ka shkuar mirë, konstaton se kanë shkuar, numrin e madh të kartave të skaduara. Ky është fakt që u diskutua dhe ditën e djeshme dhe nuk u mohua as nga... Madje KQZ-ja vetë në relativë publike dhe në ditën e zgjedhjeve, në kujtesën time ka shpjeguar këtë fakt, që ka pasur zgjedhës, kanë pasur ID të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024*

skaduar. Gjithashtu dje u soll një shifër nga pala tjetër që numri i zgjedhësve dhe mendoj se është një shifër që nuk kontestohet, numri i zgjedhësve ka ardhur në rritje, nuk e di 700 apo 1000 zgjedhës, jam i saktë? Tani ju morët një numër... Unë ju kuptoj që do keni të drejtën tuaj do bëni pjesën e mbështetjes së ankimit, morët një numër prej 1300 e disa, nuk e di çfarë termi ishte i saktë por kishim rastet e identifikimit, pra u shpjegua dje nga përfaqësuesja e KQZ-së, e IT-së, që pajisja PEI në momente të caktuara, kur personi shkon në qendrën e gabuar, të identifikon që s'je në atë qendër dhe orientohesh dhe shkon në qendrën tjetër dhe nga 1300 e ca, vetëm 22 prej tyre nuk kishin vajtur për së dyti. Pra këto 1300 e ca ju po na i relaton si pengim për të votuar. Që të jemi seriozë, ose e kuptuam gabim ne çfarë thatë, besoj jeni i qartë për këto 1300 raste çfarë përfaqësojnë?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Jo, nuk jam i qartë sepse nuk është... Shikoni unë ju kuptova dhe e kuptoj qëndrimin tuaj, por sikundër e thamë dhe në fillim nuk pata mundësi ta shpreh, ajo tabelë për sa kohë doli me lementë anormalë u përdor për termin në mos gaboj, në lidhje me pasaportat e vlefshme, numri total i pasaportave të vlefshme në gjithë Bashkinë e Himarës mendoj që nuk është, nuk ka seriozitetin e duhur për të folur në tërësi dhe pa i hyrë detajeve. Megjithatë edhe sikur ta marrim të mirëqenë unë mendoj se aty ka pasur një problematikë me ato 1438, sa ishte shifra ekzakte. Megjithatë ju do ta gjykon dhe ky është qëndrimi ynë në lidhje me këtë shifër, por për sa i përket, përfitoj nga rasti, për sa i përket materialet që na u vunë në dispozicion, unë përveç këtyre kam kërkuar materialet nga administrata e KQZ së që ndodhen në kuti, regjistrat e posaçom sepse aty janë shënuar manualisht, kjo është ajo që na ka ardhur si informacion, janë shënuar manualisht personat që kanë votuar dhe janë shënuar gjithashtu manualisht 560 zgjedhës që ju është ndërprerë procesi në mes.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024*

**Z. K. Bele:** Më fal, çfarë kuptioni me ndërprerje të procesit, si term që ta kuptoj unë?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Kanë shkuar të votojnë, votuan dhe arritën të votojnë në maj 2023 dhe karta duke qenë e skaduar i është pamundësuar procesi i votimit.

**Z. K. Bele:** Kam një pyetje unë, ju besoj e dini se, mos të bëhem përsëritës, këto janë në çdo qendër votimi subjektet kanë pasur përfaqësues të tyre dhe subjekti që përfaqësoni gjysmën e qendrave ka pasur shumicën. Pse nuk i kanë lejuar këta të votojnë?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Prandaj duam të shohim se çfarë është shënuar në ato materiale dhe gjykojmë që këto prova do të na duhen dhe do t'i shërbejnë subjektit ose palës së tretë edhe për ankimimet e tjera. Kështu që për ne, e gjykojmë të domosdoshme që t'i marrim ato prova. T'i kemi në dispozicion, t'i vlerësojmë, t'i gjykojmë dhe të japim qëndrimin tonë përfundimtar. Ne besojmë që është e drejta jonë.

**Z. K. Bele:** Pra, ju e quani ndërprerje? Një proces i cili nuk mund të fillonte ligjërisht po ju pretendoni të përdorni termin ndërprerje?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Ndërprerje për pjesën e votimit? Po për pjesën e votimit.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*  
*Dt. 22.08.2024*

**Z. K. Bele:** Ndërprerje që doli nga shpia dhe vajti te qendra? Kështu i bie. Megjithatë dakord, është e drejta juaj të përdorni termin që preferoni.

**Z. E. Lako:** Kam dy pyetje për përfaqësuesin e palës ankuese, gjatë pretendimeve tuaja ju ngritët një pretendim që ka të bëjë me rast që janë lejuar që të votojnë persona karta të skaduara. Keni ndonjë provë për këtë? Ndonjë rast që është lejuar të votojë dikush me kartë të skaduar, pra dhe pastaj ta krahasojmë me procesin që nuk janë lejuar të votojnë me karta të skaduara. E dyta ka të bëjë me kërkesën tuaj kryesore për hapjen e kutive të materialeve zgjedhore, që patjetër do kërkojë një vendimmarrje të KAS-it dhe ne do ta marrim atë por duhet pak më spccifike, c kërkon vetëm për të evidentuar që a ka raste të evidentimit të personave me karta të skaduara dhe të cilat nuk janë lejuar të votojnë apo kërkon për të parë dhe ndonjë shkelje tjetër eventuale? Se kërkesa duhet bërë specifike edhe duhet të jetë e mbështetur në ndonjë provë apo në ndonjë indicie konkrete, jo në mund. Çfarë doni të arrini? Në qoftë se evidentohet që ka një numër votuesish që nuk janë lejuar të votojnë me karta të skaduara. Ku doni të arrini? Çfarë doni të nxirri me këtë pretendim?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po ju kuptova drejt. Ne e kemi bërë kërkesën dhe dje dhe patëm mundësi ta debatojmë, kërkesa është e thjeshtë, është për të evidentuar që të paktën 560 zgjedhës nuk janë lejuar të votojnë prandaj e kërkojmë këtë provë. Për të evidentuar që në regjistrat e posaçëm, 560 zgjedhës na është thënë që nuk janë lejuar të votojnë dhe është shënuar atje, për shkak të kartave të skaduara. Është mbajtur shënim dhe gjithashtu për të paktën 260 votues të cilët kishin këtë problematikën tjetër. Këtë e kemi sqaruar disa herë. Prandaj ajo që duam, kjo është pyetja që na keni bërë dhe dje faktikisht dhe ajo që duam të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024*

evidentojmë është që të gjitha këto shifra po të mblidhen bashkë, të gjitha këto shifra me votime me probleme arrijnë dhe e tejkalojnë pse jo dhe diferencën midis kandidatëve. Kjo është ajo që duam të dimë ne.

**Z. E. Lako:** Për pyetjen e parë që ju bëra keni ndonjë koment, që keni ndonjë rast që janë lejuar me dokument të skaduar?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i BF:** Kemi marrë informacion nga terreni, nga KZAZ-ja dhe përfaqësuesit tanë që ka pasur disa raste të tilla ku mund të jetë votuar edhe me kartë të skaduar.

**Z. E. Lako:** Por provë nuk keni.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Nga ajo që pamë dje ishte rasti i kundërt kur dokumentin ata e kishin të vlefshëm, kartën ose pasaportën, ndërkohë dilnin që s'kishin mundësi të votonin sepse dilte dokumenti i skaduar në aplikacion.


**Z. E. Lako:** Ajo u sqarua, nuk ka të bëjë me lejimin apo jo. Ajo ka të bëjë me një evidencë që u sqarua nga administrata.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po do parë sa raste ka pasur dhe mund të ketë dhe a është lejuar të votojë realisht apo jo personi. Megjithatë e lëmë në vlerësimin tuaj, ne kërkesat i bëmë. Po i ripërsëris dhe njëherë megjithatë KAS-i është ai që vendos.

**Z. K. Bele:** Ndonjë pyetje? Ilir na dëgjon?

*Zbardhi materialin audio*

*Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024*

**Z. I. Rusmali:** Po unë ju dëgjoj, të marr kohë sa të hap mikrofonin. Ndoshta mund të bëja unë ndonjë pyetje të vogël, në qoftë se e kam mundësinë?

**Z. K. Bele:** Po.

**Z. I. Rusmali:** Atëherë desha të di nga ankuesi, dua ta lidh me atë që sapo tha, kam informacione nga përfaqësuesit e tyre në terren, besoj anëtarë të komisioneve të qendrave të votimit ose vëzhgues, që disa persona me karta të skaduara janë lejuar gjithsesi të votojnë. Unë doja të nisja në këtë pikë, ky informacion që ata kanë, e para a është i kuantifikuar? Dihet sa persona me karta me karta të skaduara janë lejuar të votojnë? E dyta, informacioni që ka ankuesi për këta persona bën fjalë për qendra votimi të identikuara në të cilat persona të tjerë, në të njëjtën situatë nuk janë lejuar të votojnë apo informacioni nënkuption që në disa qendra votimi është zbatuar rregulli kush e ka kartën të skaduar nuk lejohet të votojë dhe në disa qendra të tjera rregulli që kush e ka kartën të skaduar gjithsesi mund të votojë. Mund ta sqarojmë këtë pikë në qoftë se është e mundur?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po, nuk e kam informacionin e plotë se nëse ka qenë varianti i parë apo varianti i dytë i pyetjes tuaj. Nëse ndodh qoftë njëra apo qoftë tjetra dhe nëse vërtetohet me prova shkresore që ka ndodhur qoftë njëra, qoftë tjetra, gjykoj se këtu jemi përpëra një problemi të madh ligjor sepse ka të bëjë me shkeljen e barazisë së votës. Kështu që kjo do mbetet për t'u parë dhe për t'u kuantifikuar në momentin që do na vihen në dispozicion këto prova.

**Z. I. Rusmali:** Unë jam dakord me sapo tha z. Nuri, që në qoftë se vërtetohet kjo gjë jemi vërtet përpëra një problemi të madh ligjor. Unë do ta lexoja jo si shkelje e

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve*  
*Dt. 22.08.2024*

barazisë së votës po si shkelje standardi në votim sepse në qoftë se një qendër votimi përdor dy standarde për zgjedhësit që janë në të njëjtat kushte, do të thotë dyshimi parësor është që në atë qendër votimi është bërë seleksionimi i zgjedhësve sipas ...dhe kjo është shkelje e rëndë që mund të çojë deri në pavlefshmëri, po për këtë besoj që nuk mund të vimë në nivelin e hipotezave. Ankuesi duhet të kishte prova në dispozicion dhe të thoshte po kjo ka ndodhur sepse në qoftë se mungojnë provat pastaj gjithçka tjetër nuk ka asnë vlerë, janë hipoteza ose diskutime akademike. Unë kam nevojë edhe një pyetje dhe nuk besoj se kam nevojë të bëj më. Për ankuesin, dua një lloj analize ligjore, pse ndalimi i njerëzve me karta të skaduara për të votuar formon shkelje të ligjit? Ne na duhen shkelje të ligjit, pse kjo është shkelje e ligjit dhe nëse është e tillë cili ligj përcakton që mund të lejohen me karta të skaduara zgjedhësit?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Pikërisht këtë desha të kuptoj dhe unë, nuk e di mbi ç'bazë ligji janë lejuar në tre palë zgjedhje në Bashkinë Himarë të votojnë këta zgjedhës me karta të skaduara? Ndoshta Këshilli i Ministrave paska shkelur ligjin kur i ka lejuar të votojnë me karta të skaduara. Karta në vetvete, letërnjoftimi që ka pas qenë dikur në Shqipëri ka qenë copa e letrës, për ta banalizuar, ajo thjesht tregon se kush është individi, nuk tregon, vlefshmëria e saj nuk tregon në vetvete që personi nuk është ai, ai shërben për të identifikuar a është personi. Në vlerësimin tim, a është ky person apo jo që paraqitet në një moment të caktuar që është dhe procesi zgjedhor por mund të përdoret një kartë e skaduar edhe për proces identifikimi nga organet e tjera ligjzbatusese se do të thotë që karta dikur mund të ketë në xhep në ndonjë moment të caktuar, në një kontroll policor ka skaduar dhe policia thotë nuk e identifikojmë dot se kush është ky person sepse karta paska skaduar, pra unë dua të bëj një dallim midis kartës, suportit e

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimoreve dhe Sanktioneve  
Dt. 22.08.2024*

materialit, vlefshmërisë së saj dhe vlerës së përputhshmërisë që ajo mund të ketë përfekt të zgjedhjeve. Megjithatë unë e kuptoja pytjen tuaj shumë mirë ne e kemi analizën ligjore të bazuara mbi norma kushtetuese dhe mbi parimin e sigurisë juridike, kur siç thashë dhe dje është lejuar të votojë me kartë të skaduar, ai mendon që ka të drejtë mendon dhe beson se do ketë të drejtë të votojë dhe kësaj radhe sepse kjo ka ndodhur dhe tre herë të tjera në Himarë sipas asaj që kemi lexuar dhe nga raporti i KRIIK-ut që është një institucion i pavarur, kontrollon dhe sheh, monitoron zgjedhjet. Pra, siguria juridike gjykoj unë është problemi më i madh i analizës juridike, barazia e votës po ashtu. Ajo që ju evokuat më përpara dhe ju falenderoj që e evokuat sepse ma rikujtuat z.Rusmali për pjesën e votës së kontrolluar. Ju përmendët diçka të tillë, votës së kontrolluar, po patjetër unë në këtë kontestim, në këtë ankirim nuk desha të hyj në aspektet që janë elementë politikë deri diku, por patronazhimi është një problem i rëndë i zgjedhjeve në Shqipëri, përdorimi i administratës është një element tjetër që fatkeqsisht janë banalizuar dhe patjetër që ne kemi dyshimet tona që kanë ndodhur dhe gjëra të tillë në Himarë dhe ata që janë në terren i dinë dhe i njojin shumë mirë problematikat e këtyre palë zgjedhjeve, por nuk desha të hyj në këtë lloj analize. Megjithatë e ripërsëris dhe njëherë është shkelja e barazisë së votës, është problemi kryesor dhe cënimi i sigurisë juridike, pengimi mbi, potencialisht i qindra zgjedhësve të votojnë, përfaktin se nuk u mor një vendim qeverie që vitet e tjera është marrë përgjithë Shqipërinë. Potencialisht ka penguar me 560 zgjedhës po mund të ketë penguar dhe të tjerë që kanë marrë informacion atë ditë që shikoni se mos hajdeni fare në qendrat e votimit se kësaj radhe nuk u lejoka, ndryshe nga herë e tjera.

Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*  


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024*

**Z. I. Rusmali:** Në qoftë se mund ta, domethënë se përgjigja si të thuash nxit interesin. Mund të bëj dhe një pyetje tjetër në qoftë se më lejohet?

**Z. K. Bele:** Po, patjetër!

**Z. I. Rusmali:** Dakord, i takon KAS-it të analizojë faktin që moslejimi i personave me karta të skaduara formon cënim të praktikës të mëparshme sepse mesa duket siç e tha z. Nuri nuk është referencë tek ligji por është referencë te praktika e mëparshme. Gjithashtu i takon KAS-it të arsyetojë nëse skadimi i afatit e bën dokumentin të pavlefshëm për identifikim apo gjithsesi një dokument që si rregull lëshohet për 10 ose për 15 vjet pas kalimit të afatit i ruan vlerat për identifikim. Ky është diskutim që do ta bëjë KAS-i në shqyrtimin përfundimtar në vendimmarrje e tij po unë desha të di, ne duam...Ligji kërkon shkelje të ligjit, kushti i parë për shpalljen e pavlefshmërisë, por shkeljet kërkon ligji duhet të plotësojnë dhe një kusht tjetër, duhet të jenë në përmasë të tillë që mund të kenë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve. Ju keni pretenduar që është një shifër prej rreth 500 zgjedhësish që kanë qenë në këto kushte, pra në kushte kur kanë dashur të votojnë po për shkak të skadencës së kartës nuk janë lejuar të votojnë. Shifra pre 500 zgjedhësish, 500 ose 600 nuk ka rëndësi për mua po shifra që ju referoni, mund ta analizoni është e tillë që ndikon në rezultatin e zgjedhjeve?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po, faleminderit për pyetjen! Atë jam përpjekur ta them dhe herët e tjera ndaj pyetjeve të z.Lako që ku deshëm të arrijmë me këto shifra që ne kemi paraqitur. Patjetër që tek ajo, tek dispozita e ligjit dhe Kodi Zgjedhor që e parashikon në rast se ka diferençë midis kandidatëve, duhet që kjo diferençë të vihet në dyshim me anë të...Po e marr inverso arsyetimin, duhet të


*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024*

vihet në dyshim me anë të shifrave që potencialisht mund të kenë arritur, pra vota të tilla që mund të kenë arritur ta vënë në diskutim diferencën midis kandidatëve dhe patjetër që ne kemi shifrën e faktuar tashmë prej 6157 zgjedhës në total nga rreth 23000 zgjedhës të regjistruar, kanë votuar 8500 herën e kaluar dhe nga 8500 që kanë votuar, ne pretendojmë për rreth 560 të penguar atë ditë për efektin e kartave që nuk është një shifër e vogël në raport me 8500. Po ashtu, unë e thashë në fillim, në pyetjen e mëparshme, potencialisht dëmi mund të jetë më i madh dhe është patjetër më i madh sepse këta 560 banorë të Himarës, qytetarë që nuk janë lejuar të votojnë, ndryshe nga herët e tjera, e kanë përhapur fjalë, kanë ardhur, kanë folur me njerëzit e tyre, me të afërmit e tyre dhe ata nuk kanë shkuar fare dhe nuk janë identifikuar fare më pas sepse ishte e kotë të shkonin se nuk do të lejoheshin të votonin ndryshe nga herët e tjera, një vit më përpara. Prandaj dëmi këtu është potencialisht më i madh, po ne nuk po ndalemi vetëm këtu, kemi dhe shifrën e mbi 300 zgjedhës të shtuar së fundmi nga bashkitë e tjera që dhe atë e kontestojmë. 260 zgjedhës të tjerë me karta të rinovuara në ditët e fundit, në momentet e fundit, aq sa dhe PEI nuk i ka njojur dhe këtë orientim po e them sepse ne na është dhënë si orientim që këta mund të kenë qenë potencialisht zgjedhës të patronazhuar, pra mund të jetë votë e kontrolluar sepse ka një qëllim pas saj sepse përtej shifrave pse janë bërë këto? Pse arritëm në këtë situatë? Nëse qeverisë do t'i leverdiste që zgjedhësit të votonin në Bashkinë e Himarës patjetër që nuk i kushtonte asnje gjë ta mbledhje Këshillin e Ministrave me sekonda për të marrë atë vendim që nuk u mor, por ne dyshojmë dhe kemi dyshime të arsyeshme që janë trajtuar qytetarët e Himarës me dy standarde, ata që i leverdiste qeverisë ju është dhënë dhe mund t'iu jetë dhënë ndihma e nevojshme për t'i rinovuar kartat në kohë rekord, të tjerët mund të janë vonuar, nuk janë njoftuar e me radhë. Pra të gjitha këto shifra që

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanktioneve  
Dt. 22.08.2024*

përmenda e vënë në dyshim në vlerësimin tonë shifrën prej 1470 vota diferencë midis dy kandidatëve.

**Z. I. Rusmali:** Z. Nuri për ta kompletuar diskutimin për dy kategoritë e tjera që ju përfshitë, ju keni të dhëna sa persona kanë kërkuar që të rinovojnë kartat dhe janë penguar për rinovimin e tyre?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Këto të dhëna nuk i disponojmë për momentin por do të ishte pse jo një gjë shumë e mirë sikur KAS-i apo KQZ-ja t'i drejtohesin Drejtorisë së Gjendjes Civile dhe ta dinin këtë shifër. Do të ishte mjaft interesante për gjykin e kësaj çështjeje dhe thelbit të saj.

**Z. I. Rusmali:** Të lutem e disponon Gjendja Civile një të dhënë të tillë apo aplikimi online na jep mundësinë për ta verifikuar?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Këtë gjë nuk di ta them, nëse është Gjendja Civile që mund ta disponojë këtë apo AKSHI, apo e-albania, këtë nuk e di. Ndoshta janë institucione të shtetit por do të ishte e udhës t'i drejtohej edhe këtyre institucioneve për të bërrë një hetim dhe një trajtim të gjithëanshëm të kësaj problematike.

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Domethënë ngelemi gjithmonë tek historia që KAS-i duhet të sigurojë prova! Pjetja e fundit, një analizë ligjore, e njëjtë siç e bëra pyetjen më përpara, këta 300 persona që kanë lëvizur në periudhën e fundit thoni ju kanë ndërruar pasaportizimin me termin e vjetër. Pse përbën shkelje të ligjit zhvendosja e vendbanimit nga këta 300 persona?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Është e dyshimtë. Së pari kjo zhvendosje në këto përmasa, këtë duhet ta pranojmë të gjithë, diferenca e votave në Himarë herën e kaluar ishte 18 vota dhe zhvendosja sipas dokumentit që na u vu në dispozicion dje në Himarë, krahasuar me listën përfundimtare të zgjedhësve të vitit 2023, sipas këtij dokumenti i Gjendjes Civile, i Drejtorit të Gjendjes Civile, ka pasur 32. Pra, herën e kaluar ka pasur 32 zhvendosje, kësaj radhe 10 herë më shumë, në një bashki ku diferenca ishte më pak se 20 vota, ka pasur 311 zgjedhës deri në qershor. Ndërkoq që nga momenti i dekretimit të zgjedhjeve sipas raportit të KRIIK-ut, i referohem atyre kishte të paktën 96 zgjedhës që u shtuan dhe pati dhe denoncime publike, me emra publikë po pa i përmendur këtu. Persona që mund të kenë votuar z.Rusmali në maj të 2023 në Bashkinë e Tiranës apo në bashki të tjera, ndërkoq votojnë dy herë për zgjedhje vendore sepse shkojnë në Himarë dhe votojnë prapë në Himarë dhe janë disa emra, u përmendën dhe media apo në portale të ndryshme. Besoj e kuptioni se këtu ka një shkelje të barazisë së votës deri diku sepse mund të ketë persona me dy vota brenda një procesi, në kuptimin e një palë zgjedhjeve vendore që njëherë votojnë në Tiranë apo në Tepelenë apo në... Njëherë votojnë në Himarë mbas pak muajsh sepse po ripërsëriten zgjedhjet. Unë e kam quajtur këtë zgjedhës shëtitës se mund të ketë zgjedhje të pjesshme edhe në bashki të tjera tanë, hajt t'i zhvendosim të vijnë këtu dhe të votojnë.. Kështu që unë gjykoj që ka problematika në këtë aspekt.

**Z. I. Rusmali:** Dakord po ligji shqiptar i Gjendjes Civile kërkon që kur një person lëviz për një periudhë më të gjatë se tre muaj nga një vendbanim në një tjetër është i detyruar të bëjë regjistrimin e pasaportizimit në vendbanimin e ri, në qoftë se mendon se do rrrijë mbi tre muaj, përndryshtë mbi të vendoset gjoba. Nga këta 300 persona, pavarësisht se shifra në analizë statistikore mund të duket e panatyrshme,

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024*

ne na duket e paligjshme, jo e panatyrshme që të mund të veprojmë, nga këta 300 persona sa keni identifikuar ju që janë regjistruar në kundërshtim me ligjin? Pse duhet të na i identifikoni?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Nga informacionet që ne kemi në terren po ju sqaroj që na është bërë me dije se për këto raste dhe shkelje të tjera është depozituar dhe kallëzim penal përkatës, të paktën ky është informacioni që unë disponoj, ndërkohë për shifra konkrete se sa nga këta persona mund të jenë në këtë rast që thoni ju që kanë, pra në rastin që kanë më pak se tre muaj se kështu i bie, këtë nuk e disponoj si shifër aktualisht por është e vërtetë ajo që u tha dhe bashkohem me ju për pjesën që është e panatyrshme, jo vetëm e panatyrshme por është jonormale që të ndodhë një zhvendosje kaq e madhe votuesish në një bashki me... Kur në të shkuarën ka pasur vetëm 32, pra 10 herë më pak zhvendosje votuesish. Nga informacionet që ne na janë dhënë për ta ilustruar edhe mund ta keni referuar dhe me shkrim në kërkesën tonë thuhet nga terreni që kanë ardhur persona të regjistruar dhe në karabina, pra jo në banesa të ligjshme apo ka pasur nga burime të mediave të hapura, janë referuar punonjës të hoteleri-turizmit në Himarë kanë pasur mundësi që të regjistrohen si zgjedhës dhe të votojnë aty. Pra janë një sërë rastesh të tillë për të cilat është depozituar dhe kallëzim penal sipas informacioneve që ne disponojmë.

**Z. I. Rusmali:** Mirë, unë besoj se s'kam pyetje të tjera më shumë për këto tema.

**Z. K. Bele:** Faleminderit. Nëse s'keni pyetje të tjera vazhdojmë me procesin. Po keni? Nga ana e KQZ-së ka ndonjë qëndrim për të mbajtur ose ndonjë element që doni të shton?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024*

**Z. M. Bardhi:** E lëmë ta çmojë KAS-i.

**Z. K. Bele:** Dakord. Në përfundim të parashtrimeve dhe argumentave të dëgjuara nga palët në seancën e djeshme u la të diskutohet lidhur me kërkesën e bërë nga ana e ankuesit për pikën 3 dhe 4 të kërkesës për provën lidhur me marrjen e disa materialeve që gjenden në kutitë e materialeve zgjedhore. Ajo që ka të bëjë sipas tyre me shkeljet e pretenduara të përjashtuar. Në këto kushte...

**Z. E. Çefa:** Unë kam një pyetje për përfaqësuesin e ankimuesit, cilat janë, a mund të na i citoni saktësisht tani, cilat janë provat që ju doni të merrni nga kutitë? Pra, çfarë tip dokumentacioni kërkon?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Atëherë ne e kemi depozituar me shkrim kërkesën në KQZ. Po e ripërsërisim dhe njëherë i nderuar. Kërkua është ato elementë që nuk na u vunë në dispozicion nga KQZ-ja dhe administrata. Sipas administratës këto elementë nuk i kishin sepse gjendeshin në kutitë prandaj po kërkojmë dhe ne të hapen kutitë e materialeve zgjedhore dhe saktësisht kërkojmë “Regjistrat e posaçëm” të 36 qendrave dhe kopjet e “Procesverbaleve”. Ne e kemi bërë pak më të gjerë formulimin apo të dokumentave të tjerë ku mund të jenë shënuar manualisht, nuk ka rëndësi emri, suporti mund të jetë shkruar, nuk e dimë se si mund të jenë shkruar po aty ku dokumenti mund të jetë shkruar manualisht 260 votues apo më tepër që kanë pasur problematikën e mosnjohjes nga PEI, ndërkohë që karta e tyre ishte rinovuar pak ditë përpara.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024*

**Z. E. Çefa:** Kjo nënkuption se në qoftë se duhet të hapen kutitë ju duhet të jeni prezent në vend që të shikoni eventualisht çdo dokument që ta konsideroni të nevojshëm dhe të thoni dua, kërkoj këtë, kërkoj këtë.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** “Librin e protokollit të mbledhjeve”.

**Z. E. Çefa:** Se kështu me përkufizim të përgjithshëm, pra domethënë me një gjuhë të thjeshtë.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Suportin ku mund të jenë mbajtur shënim këto gjëra, mund të ketë qenë “Libri i protokollit”, mund të ketë qenë një procesverbal, nuk e di. Administrata e KQZ-së thotë që ato janë në...

**Z. E. Çefa:** Po këto do kërkojnë, pra, përtej vlerësimit të administratës kjo do të kërkojë praninë tuaj në vend që t'i shihni vetë domethënë ato që doni. A më kuption? Se ajo çfarë mund të jetë e rëndësishme për ju mund të mos jetë e rëndësishme për një punonjës të administratës që hap kutitë. Pra vetëm në këtë prizëm e kisha.

**Z. E. Lako:** Në vijim të kësaj z. Nuri do të hapen kutitë e materialeve zgjedhore nuk mund ta lini ta çmojë administrata për të parë se çfarë doni ju. Kërkesa dhe vendimi eventual që mund të merret do të jetë specifik, që do të hapet kutia e materialeve për të marrë këtë dokument, nuk mundet të hapet kutia dhe ju të studioni katinë, se ashtu i bie që është një proces që nuk mbaron. Brenda kutisë së materialeve zgjedhore ka shumë dokumenta, pra duhet të jetë specifike kërkesa, kërkojmë të njihemi me “Librin e protokollit”...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** “Libri i protokollit të mbledhjeve”, “Regjistrin e posaçëm”.

**Z. E. Lako:**... “Regjistri i posaçëm” nuk ka informacionin që kërkon ju, ka votuesit...

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Ndoshta është kështu, ndoshta i kanë shënuar gabim atje ku nuk duhet ta shënonim, ta shohim.

**Z. E. Lako:** Këtë nuk mund ta lëmë në vlerësim të procesit se si e ka bërë punën komisioni i qendrës së votimit, ata e bëjmë në një moment të dytë. Ne do hapim kutinë nëse do ta hapim për të marrë një dokument që i shërbën këtij procesi, pranë nuk është se do gjejmë kutinë e se thamë dhe herës tjetër. Mirë, faleminderit!

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** E kuptoj. Gjithsesi ne do kërkonim që pasi të hapeshin le të na vihet në dispozicion një kopje e tyre.

**Z. L. Braho:** Franci vetëm për të sqaruar një gjë dhe në vijim të asaj që thanë kolegët, ideja është ta saktësosh, do “Libër protokolli”, do “Listën e posaçme të zgjedhësve”, këto dy dokumenta do?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po dhe “Regjistrin” që mund të kenë mbajtur shënim pranë.

**Z. L. Braho:** Po s’ka, “Libri i protokollit”, nuk ka regjistër.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Registër, çfarë mund të ketë.

**Z. L. Braho:** Po listën e zgjedhësve e do? Se mos thuash pastaj dua dhe listën e zgjedhësve? Më kupton? Mendoje dhe njëherë edhe nuk e di në qoftë se keni ndonjë manual të qendrës së votimit që rifreskojë ankuesi dhe memorien në lidhje çfarë dokumentacioni ka qendra e votimi. Se ata mund të kenë futur dhe ndonjë fletore aty.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Prandaj po them.

**Z. L. Braho:** Mirë pra.

**Z. K. Bele:** Aty gjen dhe flamurin ndonjëherë.

**Z. L. Braho:** Flamuri, janë dhe këto të shenjave të gishtit. Ta qartësojmë çfarë duhet se nga momenti që vendoset, në qoftë se do vendoset nuk mund të ndryshojë më.

**Z. M. Bardhi:** Atëherë referuar nenit 113 për veprime që kryen qendra e votimit pas mbylljes së procesit të votimit, në kutinë e materialeve zgjedhore ndodhen: “Fletët e votimit të dëmtuara”, “Të padëmtuara”, “Lista e zgjedhësve” përfshirë dhe “Regjistrin e posaçëm”, origjinalet e vendimeve të KQV-së dhe formularët tip të përdorura në vendimin e KQV-së, vulat, vulat e kryetarit, vulat me kodet e sigurisë, vulat me kodet e sigurisë së dëmtuara, “Libri i protokollit të mbledhjeve”.

**Z. K. Bele:** Pra, do ta specifikoni kërkesën tuaj z. Nuri?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Vetëm një moment sa të njihem me, dy minuta kohë sa të njihem me këto materiale që sapo m'u vunë në dispozicion nga administrata e KQZ-së.

**Z. K. Bele:** Ndërpresim seancën për pak minuta sa të qartësojmë këtë moment procedural.

**Rifillon seanca**

**Ora, 12.15**

**Z. K. Bele:** Riçelim seancën. Nga ana e ankuesit do të specifikohet kërkimi i tij në lidhje me marrjen e provave që kërkohen të merren nga kutia e materialeve zgjedhore. Të dëgjojmë njëherë përfaqësuesin dhe pastaj do të shprehet KAS-i me vendim.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Faleminderit! Në lidhje me pyetjen që na u bë nga KAS se cilët elementë dhe cilët materiale ne kërkojmë konkretisht. Kërkojmë katër dokumenta, materiale: 1. “Procesverbalin e mbylljes”. 2. “Listën e zgjedhësve” të qendrës së votimit. 3. “Libri i protokollit të mbledhjeve” dhe 4. “Regjistri i veçantë.” Kërkojmë patjetër që të na vihet në dispozicion një kopje dhe koha e mjaftueshme që t’i studjojmë, t’i analizojmë. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Mirë, lidhur me këtë kërkesë KAS po tërhiqet për vendim dhe do t’ju njoftojmë për pak minuta në lidhje me pranimin ose jo të kërkesës suaj. Ndërpresim seancën.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve  
Dt. 22.08.2024  
Rifillon seanca*

*Ora 12.28*

**Z. K. Bele:** Riçelim seancën. Lidhur me kérkesën e ankuesit për hapjen e kutisë së materialeve zgjedhore për të kerkuar këqyrjen dhe marrjen e dokumentave të pretenduara KAS me shumicë vendosi rrëzimin e kérkesës për marrjen e këtyre dokumentave, pasi një kérkesë e tillë nuk gjen mbështetje në ligj dhe prova dhe nuk i shërben procesit të pavlefshmërisë që e kemi sot objekt shqyrtimi. Megjithatë duke qenë se dy anëtarë të KAS-it shfrytëzuan të drejtën që buron nga neni 21/2 si dhe praktika e konsoliduar në raste të mëparshme, u vendos, pa debat mbi kérkesën e tyre të kutitë e materialeve sipas kérkesës së ankuesit. Ky proces do të realizohet nga administrata e KQZ-së, e cila do të sillet në këtë rast si një KZAZ. Procesi do të kryhet në prezencë të palës dhe gjatë procesit do të administrohen kopje të dokumentit. Ju lutem të bëhen dy kopje dhe për palën tjetër nëse do ketë interes, pavarësisht se nuk. Sigurisht dhe kopja jonë. Ky proces të kryhet në mënyrë të pandërprerë dhe në prezencë të kamerave të KQZ por seanca për publikun e ndërpresim seancën dhe procesi do të kryhet nga ana e KQZ-së dhe do të përfundojë ditën e sotme. Duke qenë avokat se nga ana juaj në parantezë u kerkua kohë për të studjuar çfarëdo lloj informacioni që ju mendoni se do merrni nga... Cila do të ishte koha e përshtatshme? Bëheni gati për ditën e nesërme?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Në funksion të momentit që do na vihen në dispozicion, nëse arrijmë t'i marrim për një kohë relativisht të shkurtër, mund të jetë koha e përshtatshme dhe për ditën e nesërme, ditë e premte në mos gaboj.

**Z. K. Bele:** Dakord. Meqenëse ju patët..

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve*

*Dt. 22.08.2024*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Pastaj në vlerësimin tuaj gjithsesi.

**Z. K. Bele:** ...ju patët një merak të shprehur lidhur me kohën e shkurtër nga dje, sot, atëherë unë do të sugjeroj për të dhënë kohën e mjaftueshme dhe për të përgatitur duke qenë se kemi dalë përtej afatit që parashikohet për kryerjen e kësaj seance, po ishte procedura e tillë, do të kërkonim që ditën e hënë, po e lëmë seancën ditën e hënë, caktojmë përsëri orën 11.00. Kini parasysh që seanca ditën e hënë do të përfundojë dhe me shqyrtimin dhe me konkluzionet e palëve. Me kaq kjo seancë mbyllët duke urdhëruar vazhdimin e procesit nga administrata e KQZ-së. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

